

# Vizitat jashtë vendit lënë Lipjanin për dy ditë pa gjysmën e ekzekutivit

Arian Duriqi

LIPJAN, 23 MAJ – Kryetari i Lipjanit, Shukri Buja, dy nënkryetarët Banush Bytyqi e Florent Hoxha, dhe së paku 2/3 e drejtorëve komunalë nuk kanë qenë prezentë të enjten në objektin komunal, e nuk pritet të jenë as të premtën në ditën e punës së fundit të kësaj jave. Disa prej tyre janë ndodhur në udhëtime zyrtare, disa në pushime. Kryetari Buja thuhet se ndodhet zyrtarisht në Gjirokastrë për të fuqizuar binjakëzimin e krijuar ditë më parë me këtë bashki, nënkryetari Hoxha në vizitë zyrtare në Kroaci, derisa nënkryetari tjetër Bytyqi në pushim. Mirëpo, për këtë punë ka qenë i menjëhershëm edhe reagimi i shoqërisë civile. Madje organizata joqeveritare YAHR po akuzon krerët e Lipjanit se po përfitojnë benefite në kurriz të taksapaguesve.

“Organizata joqeveritare YAHR shpreh shqetësimin se si zyrtarët komunalë përfitojnë benefite të ndryshme në kurriz të taksapaguesve të Komunës së Lipjanit. Të enjten më 23 maj 2013, Komuna e Lipjanit ka mbetur pa qeverisje lokale, sepse kryetari i Komunës, dy nënkryetarët dhe 2/3 e drejtorëve të drejtorive komunale nuk ishin në vendet e tyre të punës, disa në udhëtime zyrtare e disa në pushime. Ndaj ka qenë e pamundur që të kontaktohet me dikë që do të jetë përgjegjës për menaxhimin e institucionit ekzekutiv në Komunën e Lipjanit



dhe po ashtu një gjë e tillë pritet të përsëritet edhe të premtën më 24 maj 2013”, ka thënë Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në YAHR.

Të premtën ndërkaq pritet të udhëtojnë për në Shqipëri edhe shërbyesit civilë të Lipjanit, edhe këta të fundit me para taksapaguesish lipjanas.

“Përveç mungesës së stafit politik të ekzekutivit është për të çuditur se të premtën më 24 maj do të mungojnë edhe shërbyesit civilë në Administratën Komunale të Komunës së Lipjanit, të cilët do të shkojnë për ekskursion në Shqipëri me paratë e taksapaguesve të kësaj komune. Pra, të premtën Administrata Komunale në Lipjan do të jetë e mbyllur për ofrimin e shërbimeve të qytetareve”, ka thënë Krasniqi.

Mirëpo Halit Gashi, drejtor në Ad-

ministratën Komunale të Lipjanit, ka deklaruar të enjten se Komuna nuk ka mbetur pa menaxhim siç pretendon Krasniqi dhe YAHR-i. Sipas tij, ka staf politik të mjaftueshëm që e menaxhojnë Komunën edhe me këto mungesa.

“Nuk ka mbetur Komuna pa menaxhim, sepse jemi gati të gjithë drejtorët këtu dhe po e menaxhojmë punën secili sipas përgjegjësisë”, ka thënë Gashi.

Ky hedh poshtë edhe konstatimin tjetër të shoqërisë civile se shërbyesit civilë po shkojnë në Shqipëri me para taksapaguesish.

“Shërbyesit civilë po udhëtojnë në Shqipëri me paratë e Sindikatës së shërbyesve civilë dhe me para të taksapaguesve”, ka thënë ai.